

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
CABOLO SHQIPERIA SHPK

NENI 1 - EMËERTIMI SHOQËRISË

Prej Shtetasve

ENRICO GIANNOTTI lindur në Brindisi më 16.08.1973 ,banues ne adresen:Via Tripoli 111, Rome me kombesi dhe shtetesi italiane.

GIANFRANCO MAZZOCCOLI, lindur në San Vito dei Normanni ,Brindisi Itali më 04.11.1963 dhe banues në adresen: in Via San Vito Dei Normanni , Brindisi ; me kombesi dhe shtetesi italiane

Eshte Themeluar sot ne date 01.07.2024 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "CABOLO SHQIPERIA"

NENI 2 - QENDRA E SHOQERISE

Shoqëria « CABOLO SHQIPERIA » SHPK do të ketë qendrën në Vlorë në adresën: Lagje "Pavaresia", rruga "Nermin Vlora Fallaschi", Nr.13,Zona kadastrale 8604 dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është në LEKË 300.000 (njqindmijë lekë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakeve themelues ne raportet .

1. ENRICO GIANNOTTI, kontrinon ne shumen 150.000 leke pra 1 kuote ne raportin 50 %
2. GIANFRANCO MAZZOCCOLI ,kontrinon ne shumen 150.000 leke pra 1 kuote ne raportin 50 % dhe

Me vendim të asamblese se ortakeve kapitali i shoqërisë mund të rritet në mënyrat e parashikuara ligjore.



NENI 4 - KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë 10 vjetësh.

Ajo do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit të saj dhe do të **ushtrojë veprimtarinë e saj deri më 01.07.2034.**

Shoqëria mund të shkrihet vetëm me vendim të ortakeve .

NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria do ketë objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet vijuese:

5.1-Veprimtaritë e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe shërbimeve të tjera informatike. Industrinë e softuerit dhe harduerit dhe veprimtaritë e përqendruara në ofrimin e zgjidhjeve dhe shërbimeve specifike në sektorin e teknologjisë informative, të drejtuar kryesisht për integrimin e sistemit, zhvilluesit, shitësit dhe distributuesit.

5.2-Projektimi, zhvillimi dhe realizimi i pajisjeve dhe aparateve elektronike të çdo lloji, përfshirë integrimin dhe inovacionin e produkteve dhe sistemave ekzistues (siç janë Sistemet e Konferencave, Sistemet dhe aplikacionet e video-konferencave, aparaturat e regjive televizive dhe nga salla). Projektimi i harduerit dhe firmware-it. Projektimi dhe zhvillimi i softuerit, shërbime specifike në fushën e teknologjisë informative: shkrim, ndryshim, verifikim dhe asistencë për softuer; planifikimi dhe projektimi i sistemeve informatike që integrojnë harduer, softuer dhe teknologjitë e komunikimit. Zhvillimi i sistemeve të bazuar në Inteligjencën Artificiale për menaxhimin e foljes dhe trajtimin e gjuhës natyrore (NLP).

5.3-Veprimtaritë e portaleve të kërkimit në web, veprimtaritë e përpunimit të të dhënave dhe hostingut. Shërbime të specializuara të hostingut, përfshirë hostingun e faqeve të internetit (Web hosting), shërbimet e transmetimit dhe aplikacionet e hostingut, ofrimi i shërbimeve aplikative në rrjet (ASP), strukturat mainframe për klientët bazuar në sistemin e ndarjes së kohës (time-sharing).

5.4-Veprimtaritë e kërkimit shkencor dhe zhvillimit: kërkimi bazë, punë eksperimentale ose teorike; kërkimi i aplikuar dhe zhvillimi eksperimental. Projektimi, realizimi dhe zhvillimi (R&S) në fushën e sistemeve për njohjen automatike të zërit funksionale për fusha të ndryshme aplikative si përkthimi automatik i fjalimit, Ambient Assisted Living (AAL) për përmirësimin e shëndetit të personit, telemedicinë, teleasistencën, domotikën, zgjidhjet e realitetit të shtuar dhe proceset e reja të prodhimit bazuar në teknologji të përpunimit inovativ të lëndëve të paraqitura nga zgjidhjet ICT dhe / ose IOT. Kërkimi dhe zhvillimi dhe projektimi i strukturës dhe përmbajtjes dhe / ose përpilimi i kodit të nevojshëm për krijimin dhe implementimin e softuerit të sistemit (përfshirë përditësimet), aplikimi i softuerit (përfshirë përditësimet), bazat e të dhënave, faqet e internetit, personalizimi i softuerit.

5.5-Verbalizimi, indeksimi, titrimi dhe përkthimi automatik i mbledhjeve parlamentare, këshillimore, gjyqësore dhe në përgjithësi çdo takimi. Krijimi i bazave të të dhënave. Realizimi, udhëheqja, mirëmbajtja dhe asistenca teknike e sallave parlamentare, këshillimore, gjyqësore, për konferenca, e-rooms, përfshirë sistemet harduerike dhe softuerike të regjistrimit / transmetimit audio dhe / ose audioviziv, mikrofonat dhe transmetimi i audioit, votimi elektronik, video-konferenca; prodhimi dhe pas-prodhimi i videos për qëllime televizive dhe / ose interneti dhe shpërndarja e tyre në kanale të interesit; shërbimet e qasshme për kategori të diskriminuara, si titrimi televiziv dhe web i

destinuar personave të shurdhër dhe / ose sinteza zëri e destinuar edhe për personat me shikim të kufizuar.

5.6-Organizimi, promovimi dhe / ose menaxhimi i ngjarjeve, si panairë, kongrese, konferenca dhe takime; menaxhimi i sallave për video-konferenca dhe qiraja e pajisjeve të lidhura.

5.77-Analiza dhe monitorimi i të dhënave dhe informacioneve (analiza e të dhënave) për prodhimin e raporteve dhe rishikimeve. Monitorimi i mediave, monitorimi i mediave sociale, rishikimi i shtypit, analiza e mjetet e komunikimit, klasifikimi i përmbajtjeve.

NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 2 vjeçare duke filluar nga data e sotme deri më 01.07.2026 do jetë **ENRICO GIANNOTTI** me letërnjoftim Nr. CA11462FP

Shoqëria "CABOLO SHQIPERIA "SHPK do të jetë subjekt i te drejtës shqiptare dhe do të ushtroje aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej ortakeve themelues në datë **01.07.2024**.

ORTAKET THEMELUES / ENRICO GIANNOTTI

GIANFRANCO MAZZOCOLI

Vlorë, më 1 korrik 2024 (dymijë e njëzet e kater)

S T A T U T I
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ CABOLO SHQIPERIA» SHPK

EMËRTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHËZGJATJA

NENI 1

Prej shtetasve Italian :

ENRICO GIANNOTTI lindur në Brindisi më 16.08.1973 ,banues ne adresen:Via Tripoli 111, Rome me kombesi dhe shtetesi italiane.

GIANFRANCO MAZZOCCOLI, lindur në San Vito dei Normanni ,Brindisi Itali më 04.11.1963 dhe banues në adresen: in Via San Vito Dei Normanni , Brindisi ; me kombesi dhe shtetesi italiane

Eshte Themeluar ne date 01.07.2024 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur
“ CABOLO SHQIPERIA ”

Neni 2 - Objekti

Shoqëria do ketë objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet vijuese:

2.1-Veprimtaritë e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe shërbimeve të tjera informatike. Industrinë e softuerit dhe harduerit dhe veprimtaritë e përqendruara në ofrimin e zgjidhjeve dhe shërbimeve specifike në sektorin e teknologjisë informative, të drejtuar kryesisht për integrimin e sistemit, zhvilluesit, shitësit dhe distributuesit.

2.2-Projektimi, zhvillimi dhe realizimi i pajisjeve dhe aparateve elektronike të çdo lloji, përfshirë integrimin dhe inovacionin e produkteve dhe sistemeve ekzistues (siç janë Sistemet e Konferencave, Sistemet dhe aplikacionet e video-konferencave, aparaturat e regjive televizive dhe nga salla). Projektimi i harduerit dhe firmware-it. Projektimi dhe zhvillimi i softuerit, shërbime specifike në fushën e teknologjisë informative: shkrim, ndryshim, verifikim dhe asistencë për softuer; planifikimi dhe projektimi i sistemeve informatike që integrojnë harduer, softuer dhe teknologjitë e komunikimit. Zhvillimi i sistemeve të bazuar në Inteligjencën Artificiale për menaxhimin e foljes dhe trajtimin e gjuhës natyrore (NLP).

2.3-Veprimtaritë e portaleve të kërkimit në web, veprimtaritë e përpunimit të të dhënave dhe hostingut. Shërbime të specializuara të hostingut, përfshirë hostingun e faqeve të internetit (Web hosting), shërbimet e transmetimit dhe aplikacionet e hostingut, ofrimi i shërbimeve aplikative në rrjet (ASP), strukturat mainframe për klientët bazuar në sistemin e ndarjes së kohës (time-sharing).

2.4-Veprimtaritë e kërkimit shkencor dhe zhvillimit: kërkimi bazë, punë eksperimentale ose teorike; kërkimi i aplikuar dhe zhvillimi eksperimental. Projektimi, realizimi dhe zhvillimi (R&S) në fushën e sistemeve për njohjen automatike të zërit funksionale për fusha të ndryshme aplikative si përkthimi automatik i fjalimit, Ambient Assisted Living (AAL) për përmirësimin e shëndetit të personit, telemedicinë, teleasistencën, domotikën,



zgjdhjet e realitetit të shtuar dhe proceset e reja të prodhimit bazuar në teknologji të përpunimit inovativ të lëndëve të paraqitura nga zgjidhjet ICT dhe / ose IOT. Kërkimi dhe zhvillimi dhe projektimi i strukturës dhe përbajtjes dhe / ose përpilimi i kodit të nevojshëm për krijimin dhe implementimin e softuerit të sistemit (përfshirë përditësimet), aplikimi i softuerit (përfshirë përditësimet), bazat e të dhënave, faqet e internetit, personalizimi i softuerit.

2.5-Verbalizimi, indeksimi, titrimi dhe përkthimi automatik i mbledhjeve parlamentare, këshillimore, gjyqësore dhe në përgjithësi çdo takimi. Krijimi i bazave të të dhënave. Realizimi, udhëheqja, mirëmbajtja dhe asistenca teknike e sallave parlamentare, këshillimore, gjyqësore, për konferenca, e-rooms, përfshirë sistemet harduerike dhe softuerike të regjistrimit / transmetimit audio dhe / ose audioviziv, mikrofonat dhe transmetimi i audioit, votimi elektronik, video-konferenca; prodhimi dhe pas-prodhimi i videos për qëllime televizive dhe / ose interneti dhe shpërndarja e tyre në kanale të interesit; shërbimet e qasshme për kategori të diskriminuara, si titrimi televiziv dhe web i destinuar personave të shurdhër dhe / ose sinteza zëri e destinuar edhe për personat me shikim të kufizuar.

2.6-Organizimi, promovimi dhe / ose menaxhimi i ngjarjeve, si panairë, kongrese, konferenca dhe takime; menaxhimi i sallave për video-konferenca dhe qiraja e pajisjeve të lidhura.

2.7-Analiza dhe monitorimi i të dhënave dhe informacioneve (analiza e të dhënave) për prodhimin e raporteve dhe rishikimeve. Monitorimi i mediave, monitorimi i mediave sociale, rishikimi i shtypit, analiza e mjetet e komunikimit, klasifikimi i përbajtjeve..

Neni 3 - Qendra

3.1. Shoqëria « CABOLO SHQIPERIA » SHPK do të ketë qendrën në Vlorë në adresën: Lagje “Pavaresia”, rruga “Nermin Vlora Fallaschi”, Nr.13 ,Zona kadastrale 8604 dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.2. Me vendim të asamblese se ortakeve themelues në respekt të ligjit dhe të Statutit do të mund të hapen seli, stabilimente, filiale, zyra, agjensi dhe adresa si në Shqipëri dhe jashtë saj.

Neni 4 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur të jetë 10 vjet duke filluar nga data e sotme deri me 01.07.2034.

Neni 5 - Kapitali

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në LEKË 300.000 (njqindmijë lekë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakeve themelues ne raportet .

1. ENRICO GIANNOTTI, kontrinon ne shumen 150.000 leke pra 1 kuote ne raportin 50 %

2. GIANFRANCO MAZZOCOLI ,kontrinuon ne shumen 150.000 leke pra 1 kuote ne raportin 50 % dhe

Me vendim të asamblese se ortakeve kapitali i shoqërisë mund të rritet në mënyrat e parashikuara ligjore.

5.2. Rritjet e kapitalit te shoqerise u perkasin me prioritet ortakeve ne raport me pjesemarrjen ne zoterim te tyre. Ne rastin kur nje apo me shume ortake nuk do te nenshkruajne plotesisht rritjen, pjesemarrja e mbetur e pa nenshkruar do t'u ofrohet ne parablerje ortakeve te tjere qe kane ushtruar tagren, ne raport me pjesemarrjet ne zoterim te tyre. Sidoqofte kjo e drejte do te duhet te ushtrohet brenda 15 (pesembedhjete) diteve. Ky afat fillon nga data e njoftimit me ane njoftimi noterial. Vetem nese rritja e kapitalit nuk nenshkruhet prej ortakeve te shoqerise, pjesa qe mbetet e panenshkruar (asnje ortak nuk paraqet interes) ajo mund t'u ofrohet per blerje te treteve.

5.3. Shoqeria do te mund te marre prej ortakeve derdhje dhe financime, mne forme detyrimi apo gratis, me apo pa detyrimin e shlyerjes, duke zbatuar aktet ligjore ne fuqi, duke patur vecanerisht parasysh normat ligjore qe rregullojne mbledhjen e kursimeve nga publiku. Pervecse nese eshte rene dakord ne tjetër menyre me forme te shkruar, derdhjet e bera nga ortaket ne favor te shoqerise nuk do te jene ne asnje rast me interesa.

5.4 – Krediti i ortakeve per financimin e shoqerise nuk mund te trasferohet vecmas kuotes se pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.

Transferimi i kuotave te shoqerise perfshin edhe kalimin ne rruge trashegimie, si persa i perket derdhjes ne kapitalin fillestar edhe lidhur me rritjen e kapitalit, keshtu qe transferimi do sjelle ne menyre automatike zevendesimin e pales dhenese te te drejtes me palen marrese te te drejtes, si subjekt kreditor, pro kuote, te vleres se derdhur me kete titull, si dhe miratimin e vete shoqerise per te kryer ndryshimin perkates ne librat e shoqerise.

Neni 6 - Vendbanimi

Vendbanimi (duke nenkuptuar si te tille edhe numrin e fax –it dhe adresen e postes elektronike) i ortakeve, i administratoreve, per raportet e tyre me shoqerine, eshte ai qe rezulton nga librat perkates te shoqerise. Do konsiderohen me barazi renditje adresa e postes elektronike, numri i fax –it dhe adresa (qe nenkupton rrugen dhe numrin e baneses).

Neni 7

Kufizime ne transferimin e kuotave

7 – Kuotat jane te pandashme, nominale dhe te transferueshme edhe me ane akti mes te gjalleve, sipas normave te ketij statuti dhe ligjit 9901 date 14.04.2008.

7.1 – Ky nen synon te mbroje interesat e shoqerise lidhur sidomos me homogjenitetn e perberjes se shoqerise, me kohezionin mes ortakeve dhe ekuilibrin e raporteve mes tyre: per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme per rastin e transferimit te

kuotave.

7.1.1. Me "pjesmarrje" (apo me "pjesemarrjet") nenkuptohet pjesa e kapitalit te seicilit ortak apo pjese te saj (kuotat ne rast transferimi te pjesshem dhe/ose edhe te drejtat e nenshkrimet qe i perkasin asaj.

7.1.2. Me "Transferim" nenkuptohet transferimi me akt mes te gjalleve.

7.1.3. Me shprehjen "transferim me akt mes te gjalleve" nenkuptohen te gjitha institutet e transferimit, ne kuptimin me te gjere te termit, pra shitja, shkembimi, cedimi, cedimi me pagese, transferim i mandatit fiduciar dhe dhurim.

7.2 – Ne rast transferimi te kryer pa respektuar parashikimet e ketij statuti, pervecse nulitetit dhe anulimit te aktit, bleresi nuk do te kete te drejten te shkruhet ne librin e ortakeve, nuk do te jete i legjitimuar ne ushtrimin e te drejtes se votes dhe te te drejtave te tjera administrative dhe nuk do te mund te ushtroje pjesemarrjen ne shoqeri.

7.2.1 – Ne te gjitha rastet kur nje ortak ka ndermend, permes akti mes te gjalleve dhe me cfaredo titulli, te vere apo te krijoje nje uzufukt, apo sidoqofte te ngarkoje me barre – krejtesisht apo pjeserisht – pjesen e tij te kapitalit ne favor te te treteve, do te duhet te kaperceje oferten ne parablerje ne favor te ortakeve te tjere.

Per kete qellim ortaku do te duhet, permes letre rekomande derguar ne adresen e seicilit prej ortakeve te tjere te treguar ne librin perkates te shoqerise, t'i informoje per qelimin e tij per te disponuar kuotat e shoqerise. Komunikimi i mesiperme do te duhet te permbaje kushtet e cedimit te kuotave, mes te cilave detyrimisht çmimin dhe menytrat e pagimit si dhe garancite e kerkuara. Ortaket destinatare te ofertes se permendur do te duhet te shprehen brenda 90 (nentedhjete) ditesh nga data e njoftimit dhe ne te njetat forma te pershkruara me lart, t'i deklarojne ofruesit nese kane apo jo qellim te ushtrojne te drejten e parablerjes.

Nese oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ceduesit do te ndahet mes pranuesve ne mase proporcionale me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise kapitalin.

Nese ndonje nga ortaket nuk mundet apo nuk deshiron qe ushtroje te drejten e parablerjes, e drejta perkatese kalon proporcionalisht ne favor ortakeve te cilet, ne te kundert synojne ta ushtrojne ate dhe qe nuk kane hequr dore shprehimisht dhe paraprkisht nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes qe u perket atyre.

Sidoqofte nuk do te jete e mundur, nga ana e asnje ortaku, te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.

Ne rastin kur çmimi i kerkuar cilesohet si i tepruar nga ana e cilitdo ortak qe ka shfaqur ne afatet dhe ne format e mesiperme vullnetin per te ushtruar te drejten e parablerjes, çmimi i transferimit do te vendoset nga palet me marreveshje te perbashket mes tyre. Ne rast se nuk arrihet marreveshja, palet do te procedojne me emerimin e nje arbitri i cili do te vendose çmimin e shitjes me kriteret e drejta dhe objektive, ashtu siç dhe saktosohet ne vazhdim. Arbitri do te duhet me doemos te jete i regjistruar ne librin perkates te eksperteve kontabel.

Ne rast te mos arritjes se marreveshjes per emerimin e arbitri, ai do te emerohet nga

Kryetari i Gjykeses se Vlores ne baze te kerkeses se paraqitur nga seicila pale. Ne marrjen e vendimit te tij arbitri do te duhet te mbaje parasysh gjendjen e pasurive te shoqerise, frytshmerine e saj te pritshme, vleren e te mirave materiale dhe jomateriale te zoteruara prej saj, pozicionin e saj ne treg si dhe kushtet dhe çmimin e ofruar nga bleresi potencial – i mundshem, atehere kur ky duket ne mirebesim, si dhe çdo rrethane dhe kushti tjeter qe normalisht merret ne konsiderate ne percaktimin e vleres se pjesemarrjes ne shoqeri, me vemendje te veçante kundrejt nje "çmimi te shumices" ne rastin e transferimit te paketes kontrolluese te shoqerise. Bilanci qe do merret per baze do jete jo me i vjeter se 90 dite nga data e emerimit te arbitrit. Nese çmimi i percaktuar nga arbitri do te rezultoje **me i larte** se çmimi i ofruar nga bleresi potencial, transferimi ne favor te ortakeve qe kane te drejten e parablerjes do te kryhet sidoqofte me çmimin e ofruar nga bleresi potencial; ne rastin kur çmimi i caktuar nga arbitri do te **rezultate jo me i ulet se 5% (pese per qind)** nga çmimi i ofruar nga bleresi potencial, transferimi ne favor te ortakeve qe kane te drejten e parablerjes do te kryhet me çmimin e percaktuar nga arbitri; ne rastin kur çmimi i percaktuar nga arbitri do te **rezultate me shume se 5% me i ulet)** nga çmimi i ofruar nga bleresi potencial, ortaku qe synon te vazhdoje me transferimin, do te kete mundesine te heqe dore nga synimi i tij duke njoftuar organin administrativ permes letre rekomande vajtje-ardhje, e cila do t'i percillet ne kopje edhe te gjithë ortakeve qe kane shprehur deshiren e ushtrimit te te drejtes se parablerjes, brenda afatit prej 90 (nentedhete) ditesh nga data e marrjes se vleresimit te siperpermendur te arbitrit. Ne rast se ortaku ofruet e ushtron kete tager, si oferta ashtu edhe komunikimi per ushtrimin e te drejtes se parablerjes do konsiderohen te pavlefshme per çdo efekt. Ne rast se ortaku ofruet nuk e ushtron kete tager, transferimi ne favor te ortakeve qe kane te drejten e parablerjes do te behet me çmimin e percaktuar nga arbitri.

7.2.2 – Ne rastin kur asnje prej ortakeve nuk e ushtron te drejten e parablerjes se mesiperme, apo, ne rastin kur pasi jane kryer plotesisht procedurat e permendura, asnje ortak nuk synon te bleje, transferimi i pjesemarrjes ne favor te nje te treti mund te kryhet.

7.2.3 – Ajo çka parashikohet ne kete nen eshte e aplikueshme edhe ne aktet me objekt te drejta reale gezimi dhe/apo garancie mbi keto kuota.

7.2.4 – Megjithate pjesemarrjet jane lirisht te transferueshme pa te drejte parablerje nese transferimi kryhet ne favor te bashkeshortit apo te paraardhesve e pasardhesve te shkalles se pare.

Neni 8 - Administratoret

8.1 – Shoqeria do administrohet nga nje administrator me mandat dy vjecar; per periudhen e pare 2 vjecare nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit deri me 01.07.2026 administrator do te jete z. ENRICO GIANNOTTI me letërnjoftim Nr. CA11462FP

8.2 – Me organ administrativ kuptohet administratori ose administratoret te cileve u eshte besuar se bashku apo veç e veç administrimi.

Asambleja ka fuqine qe ne çdo kohe te ndryshoje menytrat e administrimit mes atyre te

treguara ne piken e mesiperme 9.1, si dhe te modifikojte fuqite e administratoreve.

8.3 – Numri i administratoreve, kohezgjatja e mandatit te tyre dhe kompetencat vendosen prej Asamblese dhe mbeten tye pandryshueshme deri ne rast revokimi te mandatit apo doreheqje, me perjashtim te nje vendimi te ndryshem te asamblese.

8.4 Ne momentin e emerimit apo me vone asambleja e ortakeve mund te vendose ne favor te administratoreve apo te perfaqesuesve – nese jane emeruar te tille, duke i shqyrtuar rastet nje nga nje, nje shifer te pervitshme ne forme shperblimi per t'a hequr menjane vit pas viti shoqerise dhe per t'ua paguar kur mandati te kete perfunduar apo te jete revokuar.

8.5 – Administratoret mund te jene ortake te shoqerise dhe jo ortake.

8.6 – Administratoret nuk do te mund te kryejne, direkt apo indirekt (me cilesine e ortakeve, edhe me pergjegjesi te kufizuar, apo te administrato reve), aktivitete ne konkurrence me ate te shoqerise.

8.7 – Administratoret do te ushtrojne detyren e tyre deri ne momentin kur te fillojne ne detyre [administratoret e rinj](#).

Neni 9

Kompetencat e administratoreve

9.1 – Administratori ka kompetenca te plota per administrimin e shoqerise, duke qene se i eshte ngarkuar gjithçka qe nga Ligji apo nga ky Statut nuk i ka rezervuar eskuzivisht asamblese. Ne kete menyre administratoret kane tagra perfaqesimi te kufizuara lidhur me shitjen, blerjen, shkembimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme ne emer e per llogari te shoqerise; te drejten te marrin obligacione edhe ne forme kambialesh, te vene hipoteke mbi pasurite e shoqerise, te marrin pjese ne shoqeri te tjera apo ndermarrje te tjera te krijuara apo ne krijim, te kryejne veprime me llogarite rrjedhese te shoqerise dhe te perfaqesojne shoqerine prane çdo zyre tjeter publike apo private, te lejojne venien dhe fshirjen te hipotekave, transkriptimeve dhe shenime te çdo lloji, te ndjekin ne rruge gjyqesore, te revokojne dhe te nenshkruajne kompromise dhe transaksione.

9.2. Ne rast se administrimi u eshte besuar veç e veç disa administratoreve, ne rast kundershimiti te nje administratori kundrejt veprimit qe administratori tjeter synon te kryeje, kompetente per te vendosur mbi kundershite jane ortaket.

9.4. Administratoret mund te emerojne drejtore, pergjegjes te sherbimeve te veçanta, perfaqesues per akte te vetme apo per kategori aktesh.

9.4. Administratoret kane te drejten te shperblehen per shpenzimet e kryera ne funksion te punes per shoqerine; si dhe per punen e kryer ne favor te shoqerise, ortaket mund t'i caktojne nje shperblim apo kompensim. Ne rast se asgje nuk eshte vendosur ne lidhje me shperblimin e administratoreve, detyra duhet kuptuar si e kryer falas. Ne rastin caktimi te nje apo disa keshilltareve, shperblimi i tyre do caktohet nga asamblea e ortakeve, ne momentin e emerimit te tyre apo edhe me pas.

Neni 10 - Perfaqesimi

10.1. Administratori i vetem ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise

10.2. Perfaqesimi i shoqerise u perket edhe drejtoresve dhe perfaqesuesve me prokure,

ne kufinjte e fuqive qe u jane dhene atyre me aktin e emerimit.

10.3. Perfaqesimi i shoqerise ne likuidim i perket likuidatorit ose likuidatoreve ne menytrat dhe kufijte e caktuar ne aktin e emerimit emerimit.

Neni 11 - Vendimet e ortakeve

11.1 – Asamblea e ortakeve vendos per çeshtje qe ligji dhe ky statut i le ekskluzive ne kompetence te asamblese se ortakeve si dhe per çeshtje qe nje apo me shume administratore ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 10% (dhjete per qind) te kapitalit te shoqerise ua parashtrojne per shqyrtim.

11.2 – Sidoqofte, perveç sa parashikohet ne nenet e tjera te ketij statuti, i rezervohen kompetences se asamblese se ortakeve çeshtjet e meposhtme:

- a. Miratimi i bilancit;
- b. Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve;
- c. Ndryshimet e statutit
- d. rritjen dhe zvogelimi i kapitalit te shoqerise;
- e. Vendimi per te kryer operacioneve per blerjen e kuotave ne shoqeri te tjera;
- f. Vendimet lidhur me shkrijen e parakohshme te shoqerise dhe me revokimin, emerimi; revokimi dhe zevendesimi i likuidatoreve si dhe kriteret e kryerjes se likuidimit;
- g. Transferimi i qendres se shoqerise;
- h. Shitja, blerja dhe shkembimi i pasurive te paluajtshme dhe te drejtave reale lidhur me to, lidhja e kontratave te qirase me afat mbi nente vjet.
- i. Shitja, blerja dhe shkembimi i pasurive te paluajtshme dhe te drejtave reale lidhur me to, lidhja e kontratave te qirase me afat mbi nente vjet.
- i. nenshkrimi i kontratave te qirase lidhur me pasurite e paluajtshme;
- j. siper marrje dhe heqja dore nga pjesemarrja dhe interesa ne shoqeri te tjera te themeluara ose themeluese;
- k. blerja, shitja ose huazimi i degeve te ndermarrjes;
- l. emerimi i nje drejtori te pergjithshem;
- m. punesimi, pushimi, promovimi i personelit prej Drejtuesit;
- n. te gjitha veprimet e tjera per te cilat ortaket, gjate emerimit te administratoreve, i kane rezervuar vetem me autorizim te shprehur prej tyre.

Neni 12 - E drejta e votes

12.1 - Kane te drejten e votes ortaket e shkruar ne librin e ortakeve.

12.2 - Ne çdo rast vota i takon çdo ortaku ne mase perpjestimore me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.

12.3 - Ortaku subjekt i detyrimit qe do shqyrtohet, nuk mund te marre pjese ne votim.

Neni 13 - Asambleja

13.1 – Ne rast se vendimet kane per objekt çeshtjet e treguara ne nenin e meparshem

12.2, pikat a, c dhe e, si dhe te gjitha rastet e tjera shprehimisht te parashikuara bingja ligji apo nga ky statut, apo kur e kerkon edhe nje i vetem prej administratoreve ose nje

numer ortakesh qe perfaqeson te pakten nje te pesten e kapitalit te shoqerise, vendimet e ortakeve duhet te merren permes vendimit te asamblese.

13.2 – Asambleja mund te thirret nga administratoret edhe jashte qendres se shoqerise, me kusht qe te jete ne Shqiperi ose jashtë saj dhe te jete quorumi i kerkuar per vendimmarrje. Ne rast pamundesie te administratoreve, asambleja mund te thirret nga ortaku/et qe zoteron/jne te pakten 5% te kuotave te shoqerise . Asambleja per miratimin e bilancit duhet te thirret te pakten nje here ne vit brenda 180 ditesh nga mbyllja e vitit ushtrimor te shoqerise.

Asambleja per miratimin e bilancit do te mund te thirret brenda afatit me te madh prej 180 ditesh ne rast se do te rezultojne kushtet e ligjit.

13.3 – Asambleja thirret me lajmerim te shkruar i cili duhet te merret te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara datews se caktuarper mbledhjen, me leter rekomande, fax apo mesazh te postes elektronike, e cila u çohet ne adresen e shtepise qe rezulton nga librat e shoqerise atyre qe e kane kete te drejte.

Ne njoftimin e thirrjes duhet te tregohen dita, vendi, ora e mbledhjes dhe lista e çeshtjeve per t'u trajtuar.

Ne njoftimin e thirrjes mund te parashikohet nje date tjeter per nje thirrje te dyte, per rastin kur ne mbledhjen e parashikuar ne thirrjen e pare asambleja nuk rezulton ligjerisht e formuar; sodoqofte edhe ne thirrjen e dyte vlejne te njejtat shumica te parashikuara per thirrjen e pare.

13.4 – Edhe ne mungese te thirrjes formale asambleja konsiderohet rregullisht e mbledhur kur ne te marrin pjese ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise, dhe administratoret jane te pranishem apo te informuar dhe asnje nuk i kundervihet trajtimit te argumentit. Neqoftese administratoret nuk marrin pjese personalisht ne asamble, do te duhet te japin deklarate te posaçme me shkrim, e cila duhet ruajtur ne aktet e shoqerise, ne te cilen deklarojne se jane te informuar mbi mbledhjen, mbi te gjithë argumentet e vendosura ne rendin e dites dhe se nuk i kundervihen trajtimit te tyre.

Neni 14 - Autorizimet

14.1 – Çdo ortak qe ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e asamblese mund te vendose qe te perfaqesohet prej subjekti jo ortak permes autorizimi me shkrim, i cili duhet ruajtur nga shoqeria. Ne autorizim duhet te saktosohet emri i perfaqesuesit dhe te tregohen kufinjte dhe limitet e mundshme te nje nenperfaqesimi.

14.2 – Ne rast se autorizimi jepet per nje asamble te vetme ka vlere edhe per thirrjen e dyte.

14.3 – E drejta e perfaqesimit nuk mund t'u jepet administratoreve.

Neni 15 - Proçesverbali i asamblese

15.1 – Vendimet e asamblese duhet te rezultojne nga proçesverbali i nenshkruar prej te gjithë ortakeve dhe [per rastet e parashikuara nga ligji](#) edhe i vertetuar nga noteri.

15.2.– Proçesverbali duhet te tregojë datën e asamblese dhe identitetin e pjesemarrësve, kapitalin e perfaqesuar prej seicilit; menytrat dhe rezultatet e votimeve

dhe duhet te lejoje, qofte edhe me bashkelidhje, identitetin e ortakeve pro, abstenues apo kundra.

Procesverbali duhet te paraqese perfundimet e verifikimeve te bera dhe te permbliidhen, me kerkese te ortakeve, deklarimet e tyre lidhur me ceshtje te rendit te dites.

15.3 – Procesverbali i mbledhjes se asamblese duhet te transkriptohej pa hezitim ne librin e vendimeve te ortakeve. Nese redaktohet permes akti publik mund te fotokopjohet.

Neni 16

Kuorumet, perberja dhe vendimmarrja

16.1 – Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

16.2 -- Ne rastin se Asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 «Per tregtaret dhe shoqerite tregtare» ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo mjete elektronike, siç parashikon pika 3 e nenit 88 te ligjit 9901 date 14.04.2008.

16.3 – Per ceshtjet e renditura ne kete statut ne nenin 11.2 pikat c, d, e, f, h eshte i nevojshem miratimi i te pakten 75% te ortakeve pjesmarres ne asamble

16.4 – Per ceshtjen parashikuar ne kete statut ne nenin 11.2 pika b duhet miratimi me shumice te thjeshte votash ne asamble.

16.5 – Mbeten sidoqofte ne fuqi disponimet e tjera te ligjit apo te ketij statuti qe, per vendime te vecanta, kerkojne shumica specifike te ndryshme ne votimet e asamblese.

Neni 17 - Bilanci dhe fitimet

Fitimet neto qe mund te rezultojne nga bilanci do te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise, me perjashtim te ndonje vendimi te ndryshem te ortakeve.

Neni 18 - Shperndarje dhe likuidimi

Ne çdo moment dhe per çfaredo shkak shoqeria mund te shperndahet me vendim unanim te asamblese se ortakeve; normat per likuidimin dhe per emerimin e likuidatorit apo likuidatoreve do te vendosen prej Asamblese se Ortakeve sipas dispozitave te legjisllacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 19

Per gjithshka nuk eshte parashikuar nga ky Statut do t'i behet referim legjisllacionit shqiptar ne fuqi lidhur me shoqerite tregtare.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarreshjeve

Autoritetet Gjyqesore te Republikes se Shqiperise kane kompetence ekskluzive mbi te

gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Ortakeve, ndermjet ortakeve e organeve te shoqerise dhe vete shoqerise.

Neni 21 - Gjuha e statutit

Ky Statut eshte hartuar ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe italiane me te njejten vlere perdorimi. Ne rast interpretimi do merret reference kopje ne gjuhen shqipe.

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria « CABOLO SHQIPERIA » shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi, normat e ketij statuti dhe aktit themelues bashkangjitur.

Ky statut nenshkruset prej ortakeve themelues ne date **01.07.2024**.

ORTAKET THEMELUES / / ENRICO GIANNOTTI



GIANFRANCO MAZZOCOLI



Vlore, me **1 korrik 2024** (dymije e njëzet e kater)
